



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr.970/6. prot

Datë: 23/03/2020

V E N D I M

Nr. 18. Datë 23/03/2020

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E SHËRBIMIT TË TRUPIT
DIPLOMATIK MBI "AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË".
për periudhën nga data 01.07.2018 deri më datën 30.11.2019.**

Nga auditimi i përputhshmërisë, i ushtruar në "Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik" (DSHTD), u konstatua se aktiviteti i DSHTD-së, me përjashtim të disa çështjeve të trajtuara në pikën B.Masat Organizative, të këtij Vendimi, është në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi "*Auditimin e Përputhshmërisë*", të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, sipas programit të auditimit nr.970/1 prot., datë 02.12.2019 për veprimtarinë nga data 01.07.2018 deri 30.11.2019.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A.OPINIONI I AUDITIMIT:

Opinion mbi përputhshmërinë (i pakualifikuar)

Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000).

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik (DSHTD), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të DSHTD, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i DSHTD-së, me përjashtim të çështjeve të trajtuara në bazën e opinionit të pakualifikuar, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme.

Nga auditimi i përputhshmërisë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve dhe politikave, mbi të cilat realizohet programi ekonomik (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, konstatohet se ka një angazhim të strukturave drejtuese dhe atyre zbatuese në mirëadministrimin e pasurive me qëllim arritjen e objektivave për administrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, pronë e shtetit shqiptar.

Ky angazhim, konkretizohet si me vendimarrjen e Këshillit Drejtues në rishikimin dhe riformatimin e normave të administrimit të brendshëm të shoqërisë, pavarësisht kufizimit që ju imponon korniza ligjore rregullatore e njësive të tilla ekonomike.

Këshilli drejtues dhe Drejtori i DSHTD-së, në rolin e Kryetarit të këtij Këshilli, duhet të vazhdojnë maksimalisht për të shfrytëzuar mundësitë reale që kanë, si në burim të ardhurash e asetesh por dhe në burime njerëzore, për një menaxhim efektiv, eficient dhe me ekonomicitet të pasurisë publike.

Si konkluzion, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin DSHTD, rezultuan mospërputhje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur nuk janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të pakualifikuar të përputhshmërisë.¹

Ne identifikuam çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruam ato në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla, kur vetë ne , vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Aspekte të përmirësimit të mëtejshëm janë paraqitur më në detaje në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi u konstatua se për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programeve ekonomike-financiare institucioni i DSHTD, nuk bazohet në metodologji të sakta dhe në standarte bashkëkohore të menaxhimit. Në përgjithësi në zëra të caktuar vërehet

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

² **ISSAI 4000** – Udhërrëfyese i Auditimit të Përputhshmërisë.

³ **Opinionit i pakualifikuar.** - Jepet në rastet kur në opinionin e audituesit veprimtaria e subjektit përputhet në çdo aspekt material me kriteret e vlerësimit, sa i takon zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

fenomeni i tejkalimit të shpenzimeve i përsëritur dhe i paargumetuar. Ndërmarrja nuk ka një program zhvillimi aftmësëm ku të përcaktohen objektiva konkrete që të garantojnë rritjen e vazhdueshme të të ardhurave dhe rrjedhimisht të rezultatit të saj financiar. Tejkallim në shpenzime ka për zërin mirëmbajtje dhe riparime të ndryshme në masën 108.6%, për zërin “Furnitura, nëntrajtime dhe shërbime” nga 2,076,000 lekë të planifikuara në 2,371,326 lekë, me një tejkalim në vlerë absolute 295,326 lekë si dhe në zërin “Të Tjera” që për vitin 2018 ka qenë planifikuar në masën 5 mln lekë e ku rezulton se kjo është vlerë e rritur artificialisht dhe e pajustificuar. Tejkallimi i shpenzimit për këto tre zëra ka ardhur si rezultat i shpenzimeve të paparashikuara dhe një planifikimi jo të saktë nga DSHTD, për 2018. Gjatë vitit 2019, (11 muaj) në krahasim me vitin 2018, treguesit e shpenzimeve janë pothuaj të njëjtë me vitin e kaluar, por në planin vjetor kemi një planifikim të lartë në vlerë totale 188,366,840 lekë për 12-muaj, dhe një rritje në vlerë absolute prej 30,7 mln lekë më shumë se viti 2018 e cila lidhet me një planifikim të lartë në zërin “Amortizim” në masën 75 mln dhe i realizuar për 11-muaj në vlerën 35 mln ose 46,6 %. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1 të Program Auditimit faqe 15-26 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 1.1. Drejtori dhe Këshilli Drejtues, të miratojnë një pasqyrë të plotë të shërbimeve që mund të ofrohen nga ndërmarrja dhe mbi këtë bazë të përgatisin një program zhvillimi afat-mesëm për qëndrueshmërinë ekonomike të institucionit. Të marrin masa për uljen e shpenzimeve për zërin “Udhëtime e dieta” në të ardhmen si dhe për zërin “Të tjera” të cilat kanë ndikim në rezultatin financiar të ndërmarrjes.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2018 nga DSHTD janë dhënë me qira 83 objekte dhe janë përfituar prej tyre, të ardhura nga qiraja në vlerën totale 175,081,184 lekë, ndërsa për periudhën deri më 30.11.2019 (11-muaj) janë dhënë me qira 93 objekte dhe janë përfituar prej tyre të ardhura në vlerën totale 166,369,140 lekë. Ulja e tarifave të qerave krahasuar me çmimin e tregut, për disa nga subjektet qiramarrës në rastet e pall.nr.57 me adresë Bulevardi “Zogu I”, si dhe në Rrugën “Skënderbej”, të cilët nuk janë të listuar si përfaqësi e trupit diplomatik, listë e publikuar dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Punës së Jashtme, pra nuk mund të gëzojnë përfitimet e garantuara nga Qeveria shqiptare për përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë në përputhje me konventën e Vienës për marrëdhëniet Diplomatike, *kanë ndikuar direkt në uljen e të ardhurave dhe rrjedhimisht në fitimin e kësaj ndërmarrjeje*. Në mënyrë të përsëritur rezulton një studim i pjesshëm i zonës së tregut Bulevardi “Zogu I”, për vitet 2018-2019 si dhe për një periudhë 5-vjeçare çmimet e tarifimit për qerat janë të pandryshueshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2, të Program Auditimit faqe 28-32, të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 2.1. Drejtori dhe Këshilli Drejtues si organ vendimmarrës t’i kërkojë grupit të punës për studimin e tarifave të dhënies me qera të pasurisë ndërtesa, truall i lirë, truall i lirë funksional, në administrim të DSHTD-së, vënë në dispozicion për subjektet vendase dhe të huaj, të testojë tregun në përputhje me çmimin e tregut dhe çmimet zyrtare të referencës së përcaktuar në VKM përkatëse.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Kontrata **KQSV-10.2018- X -010**, e nënshkruar me DSHTD- me objekt dhënien me qira të ambjentit në katin përdhe, i cili ndodhet në adresën Rruga “Skënderbej”, Pall. Nr.8, seksioni. Nr.3 me sipërfaqe 108 m² që do të përdoret për tregti të ndryshme ushqimore dhe industriale, është tarifuar me një çmim qeraje

prej 6 €/ m², dhe qera mujore 648 euro/muaj pra një çmim më i ulët se ai i miratuar për këtë zonë me VKD dhe konkretisht 1 euro/ m² më pak, veprim që ka sjellë një fitim të munguar prej 108 euro/muaj ose 1296 euro në vit. Rinovimi i kontratës **KQSV-10.2019- X -012** për të njëjtin objekt është kryer në të njëjtat kushte duke sjellë edhe për vitin 2019 një fitim të munguar prej 1296 euro në vit. Pra në total një fitim i munguar prej 2,592 euro për periudhën në auditim. (Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1.2. të program auditimit, faqe 32-33, të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 3.1. Këshilli Drejtues të rishikojë kontratën e lidhur me Shoqërinë X, për këtë objekt dhe të kryejë tarifimin e qerasë sipas çmimeve të miratuara me VKD, për vitin 2020.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi u konstatua se në kontratën e lidhur **KQSV-12.2018-XTirana -012**, ndërmjet subjektit privat “XTirana” dhe DSHTD-së për periudhën në auditim, me object ambjentin në katin përdhe 77,7 m² + lulishte funksionale me sip.120,21 m², i cili ndodhet në adresën Rruga “Skënderbej”, Pall. Nr.4 u konstatua se çmimi i tarifimit të qerasë është 4 €/ m² për ambjentin përdhe, dhe 150 lekë / m² për lulishten funksionale e bazuar në nenin 8 të VKM nr.840, datë 17.12.2004, i ndryshuar “Për veprimtarinë e DSHTD-së”. Pra ky subjekt privat është *trajtuar si përfaqësi diplomatike dhe çmimi për m², është në dukje më i ulët se sa ai i miratuar me VKD, për këtë zonë*. Trajtimi si rast përjashtimor është në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera”, ku përcaktohet se çmimet favorizuese do të bëhen për shkak të planeve të investimeve në rastet e kontratave mbi 200 m² Konkretisht sipërfaqja prej 77,7m² duhej të tarifohet me 7 €/ m², dhe si rrjedhim do të kishim një vlerë më të madhe në të ardhurat e këtij institucioni. Konkretisht $77,7 * 3€/ m^2 = 233 \text{ euro/muaj} * 12 = 2796 \text{ euro në vit fitim i munguar për DSHTD-në si dhe për periudhën në auditim } 2796 * 2 = 5592 \text{ euro të ardhura të munguara, pasi në vazhdimësi është lidhur kontrata me këtë subject për vitin 2020, me nr.prot .1096/2, datë 22.10.2019, me të njëjtën bazë ligjore dhe më të njëjtën tarifë qeraje. (Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1.2. të program auditimit, faqe 43-45, të Projekt-Raportit të Auditimit).$

Rekomandimi 4.1. Këshilli Drejtues të rishikojë kontratën e lidhur me subjektin X për vitin 2020 dhe të rivlerësojë çmimin sipas VKD-së dhe tregut, për përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet të burimeve të të ardhurave prej qerave.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i disa kontratave të qerasë me shoqërinë gjermane X për periudhën në auditim u konstatua se:

-Në Kontratën **KQPH-10.2018** të nënshkruar ndërmjet DSHTD dhe shoqërisë gjermane X, me object dhënien me qira të apart.nr.8.2.7, i cili ndodhet në adresën Rruga Skënderbej, Pall.nr.8, shkalla nr.2, rezultoi se tarifimi i qerasë është kryer me çmim 6,03 €/ m², për një sipërfaqe **265m²** dhe afat 11-mujor. Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 01.10.2018-31.08.2019.(11 muaj). Ajo që konstatohet është se kemi një ulje prej 0.97 euro.m2 në llogaritjen dhe tarifimin e qerasë pasi çmimi i miratuar sipas VKD për vitin 2018 është 7€/ m², dhe si rrjedhim kemi një fitim të munguar prej 255 euro/muaj dhe rreth **2805 euro të munguara për 11 muaj, për vitin 2019.**

-Mungon miratimi nga MEPJ, ndërkohë kur sipërfaqja e dhënë me qera është mbi 200 m². Qeramarrësi është një fondacion privat ndërkombëtar që nuk gëzon privilegje apo status diplomatic dhe si i tillë duhet të ishte në garë si të gjithë subjektet sipas VKM nr.54, kapitulli II “Procedura e dhënies me qera dhe enfiteozë e pasurive shtetërore dhe domosdoshmërinë e hartimit të dokumentacionit përkatës, për dhënien me qera të këtyre pronave”.

Pra rezulton që nuk ka procedura konkurrimi në kundërshtim me pikën 5/a, Kreu I, të VKM nr.54, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore.

Në Kontratën **KQPH-01.2018-X-004** të nënshkruar ndërmjet DSHTD dhe shoqërisë gjermane X, me object apart.nr. 4.1.4, i cili ndodhet në adresën Rruga Skënderbej, Pall.nr.4, shkalla nr.1, me një afat së kësaj kontrate prej 01.01.2018-31.12.2018.(12-muaj). Ajo që konstatohet është se kemi një ulje prej 0.5 euro.m² në llogaritjen dhe tarifimin e qerasë pasi çmimi i miratuar sipas VKD për vitin 2018 është 7€/ m², dhe si rrjedhim kemi një fitim të munguar prej 47,66 euro/muaj ose 572 euro të munguara për një vit, për vitin 2018.

-Nga auditimi u kontatua se në të gjitha kontratat e nënshkruara ndërmjet DSHTD dhe Shoqërisë X, nuk ka asnjë nen të specifikuar për penalizim në rastet kur subjekti privat zgjidh kontratën, si dhe në asnjë prej kontratave të nënshkruara me këtë shoqëri nuk ka pagesë të ngurtësuar për garanci, fakt ky që e ekspozon drejt një risku të vazhdueshëm Drejtorinë e Trupit Diplomatik dhe shmang në mënyrë të hapur penaltitetin në rast të prishjes së kontratave nga subjektet qiramarrës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2. të program auditimit, faqe 34-37 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 5.1. Këshilli Drejtues në vendimet që merr, të vlerësojë dhe respektojë çmimet e vendosura për zonën përkatëse në përputhje me çmimet e miratuara me VKD, për të mos krijuar mungesë të ardhurash si dhe në vazhdimësi të riverifikojë dhe vlerësojë të gjitha kontratat e lidhura me Shoqërinë X, për tarifimin e qerave sipas çmimit të miratuar me VKD për vitin 2020.

Rekomandimi 5.2. Këshilli Drejtues të marrë miratimin nga MEPJ, para lidhjes së kontratave të qerasë për objekte sipërfaqja e të cilëve është mbi 200 m² në përputhje me VKM nr.54 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".

Rekomandimi 5.3. Të rishikohen kontratat e qerasë të lidhura me X duke shtuar një nen specifik për ngurtësimin e garancisë me një vlerë totale të barabartë me vlerën tremujore të qerasë përkatëse, për shmangien e risqeve me të cilat mund të përballet DSHTD, në rastin e prishjes së kontratave.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: a) Nga auditimi u konstatua se me urdhër të Drejtorit, nr 89, datë 28.03.2019 është ngritur komisioni për monitorimin e kontratave i përbërë nga tre punonjës. Ky komision nuk ka kryer detyrimet përkatëse për monitorimin e kontratave, pasi nuk ka ndjekur në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të enfiteozës dhe çdo 6 (gjashtë) muaj të hartonte akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse sipas pikës 6/c të VKM.nr.54 duke vepruar në kundërshtim me pikën VI, Monitorimi i kontratave, të VKM.Nr.54. datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore". Në relacionin bashkëngjitur urdhrat është vetëm një akt rakordim për gjashtëmujorin e parë të 2019.

b) U konstatuan se në kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet vendase nga DSHTD, për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qerave nuk janë vjelë kamatëvonesat përkatëse. Për periudhën 01.07.2018-30.11.2019, vlera e kamatëvonesave të paarkëtuara është 16,985 euro dhe 180,078 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2. të program auditimit, faqe 45-46, të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 6.1. DSHTD/Spektori i Financës të monitorojë çdo fund muaji vlerën e arkëtuar të qerave sipas mandat- pagesave në respektimin e afatit kontraktor si për subjektet vendase dhe ato të huaja që ushtrojnë aktivitete fitimprurëse në Republikën e Shqipërisë si dhe në rastet e vonesave në likuidimin e këtyre qerave të vendosë dhe të arkëtojë kamatëvonesat përkatëse.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se “Udhëtimi turistik” është kryer sipas kërkesës për blerje nr.987, datë 04.10.2018 nga Sektori i Administratës dhe zbatimit si dhe sipas Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar dhe VKM nr.840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e DSHTD –së”. Në udhëtim kanë marrë pjesë 15 persona për datat 12-15 tetor. Kryesisht udhëtimi turistik është parashikuar në monumentet kulturore të Budapestit dhe Vjenës. Udhëtimi turistik është bërë me urdhër prokurimi nr.176, datë 08.10.2018 dhe shërbimi i procedurës së prokurimit është shoqëruar me faturë nr.776, datë 17.10.2018, me vlerë totale 760,000 leke me tvsh nga operatori Matias Travel Bus. Nga sa më sipër konstatohet se kryerja e këtij shpenzimi nuk justifikohet në bazën ligjore mbi të cilën është formuluar kërkesa. Sipas nenit 11 të Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar, pika 1, ky udhëtim është kryer në muajin tetor të viti 2018, pra pa u mbyllur rezultati financiar i këtij viti dhe pa marrë miratim nga MEPJ në kundërshtim me Ligjin 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1/b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1.1 të Program Auditimit faqe 21-22 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 7.1. Këshilli Drejtues i DSHTD të marrë masa, që në rastet e planifikimit të shpenzimeve për udhëtime turistike, praktika të ketë bashkëngjitur miratimin nga organi epror MEPJ, si dhe ky veprim të kryhet pas marrjes së miratimit të rezultateve të vitit ushtrimor financiar.

8. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se janë shpërndarë shpërblime punonjësve në fund të vitit kalendarik 2018 dhe në fund të vitit financiar 2018. Me VKD nr. 25, datë 12.12.2018 është miratuar shpërblimi i punonjësve në fundvitin 2018 për 21 punonjës të administratës dhe 35 punonjës të shërbimit në vlerën 11,500 lekë për secilin punonjës, në vlerën totale 644,000 lekë. Me VKD nr. 8, datë 01.04.2019, një vendim pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit 2018, është miratuar që një pjesë e “Fondit të Shpërblimit”, parashikuar në masën 15% të fitimit neto të periudhës, është vendosur tu jepet si shpërblim personelit, në vlerën e një page bruto, referuar muajve të punuar gjatë vitit financiar 2018. Në vendim nuk është cilësuar shuma e shpërblimit, por nga kryqëzimi i të dhënave me ditarët e bankës konstatohet se ky shpërblim ka qenë në vlerën 2,572,444 lekë. Për këto shpërblime nuk është marrë miratimi nga ministri i MEPJ, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405 “Mbi kompetencat e caktimit të pagave dhe strukturës”, Neni 6, Pika 1/b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 57-59 të -Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 8.1. Këshilli Drejtues i DSHTD të marrë masa, që në rastet e planifikimit të shpenzimeve për shpërblime, praktika të ketë bashkëngjitur miratimin nga organi epror MEPJ, si dhe ky veprim të kryhet pas marrjes së miratimit të rezultateve të vitit ushtrimor financiar.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Kontrata **KQSV-05.2018-** Amb Greke - **004**, e nënshkruar ndërmjet Ambasadës Greke dhe DSHTD-së me objekt dhënien me qera të vilës nr.88, e cila ndodhet në adresën Rruga “Skënderbej” është me një afat vlefshmërie **5 vjet** dhe fillon prej 01 maj 2018 dhe mbaron në 30 prill 2023. DSHTD ka të drejtë të lidhë kontrata jo më shumë se **1 vit** në të kundërt ajo duhet të marrë miratim nga MEPJ dhe MEF, nga ku rezulton që nuk i ka marrë, veprime këto në kundërshtim me VKM nr.529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiletozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” si dhe në udhëzimin nr.906, datë 22.11.2011” Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiletozë apo

kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, përsa i përket afatit të kontratës për kohën e kryer pa miratim të MEPJ-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2. të Program Auditimit faqe 41-42 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 9.1. DSHTD të zbatojë procedurat sipas VKM përkatëse duke marrë miratimin për afatin e vlefshmërisë së kontratës për më shumë se 1 vit, nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: a) Nga auditimi u konstatua se Komisioni i ngritur me urdhrin e Drejtorit të DSHTD me nr. 1182, datë 20.12.2018 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve dhe materialeve në DSHTD për vitin 2018” në përbërje të tij ka patur Përgjegjësin e Sektorit të Planifikimit dhe Financës. Në këtë proces u konstatua se mungonte firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit.

b) Në përfundim të inventarizimit komisionet nuk kanë hartuar një raport lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, si dhe nuk kanë nxjerrë një listë të aktiveve të cilat propozohen për nxjerrje jashtë përdorimit.

c) Gjatë muajit tetor nëntor 2018 janë bërë dalje nga përdorimi dhe asgjësuar 163 njësi me vlerë 1,246,391 lekë. Komisioni i asgjësimit është ngritur me urdhrin e drejtorit nr. 243, datë 27.09.2018 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve që propozohen të hiqen nga përdorimi”. Për asgjësimin është njoftuar Drejtoria Rajonale Tiranë me shkresën nr. 970/5, datë 26.10.2018 “njoftim për asgjësimin e aktiveve”, por nisja e procedurës për nxjerrje jashtë përdorimit nuk është e lidhur me konkluzionet e një procesi inventarizimi dhe nuk është vijim i këtij procesi, por rastësor në lidhje me aktive të cilat nuk ishin në përdorim, pasi nuk funksiononin dhe ishin kryesisht të amortizuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, të Program Auditimit, faqe 73-75, të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 11.1. Drejtuesi i DSHTD të marrë masa, që në ngritjen e komisioneve të inventarizimit të mos përfshijë punonjës të cilët mund të jenë në kushtet e konfliktit të interesit.

Rekomandimi 11.2. Komisioni i inventarizimit të ketë si objektiv përveç krahasimit të gjendjes fizike me atë kontabël edhe kushtet e ruajtjes dhe cilësinë e aktiveve dhe në raste që e konsideron të nevojshme të propozojë listën e aktiveve për t’u nxjerrë nga përdorimi.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të inventarëve u konstatua se DSHTD nuk ka të reflektuar në kontabilitet dhe në inventarët e saj 10 apartamente në Romë, të blera në shumën 12,000,000 lekë, në zbatim të dekretit nr. 461, datë 17.11.1964 nga Këshilli i Ministrave i RSH. Nga komunikimet verbale me subjektin, DSHTD ka problematikë juridike të mbartur në lidhje me pronësinë e tyre, por të shuar përgjatë vitit 2013 në favor të Republikës së Shqipërisë. Në arkivën e DSHTD korrespondenca e fundit shkresore mban nr. 578, datë 12.03.2014 me lëndë “Mbi regjistrimin e 10 apartamenteve në pronësi të shtetit shqiptar” dërguar nga Ambasada e Romës për në MEPJ, në të cilën është vënë në dijeni dhe DSHTD. Sipas kësaj shkrese 10 apartamentet janë regjistruar në datën 29 shtator 2013, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Romë, por pavarësisht kësaj, për to nuk ka siguri të plotë juridike për pronësinë nga shteti shqiptar. Sipas konsulencës ligjore të kontaktuar për këtë çështje, RSH rezulton debitore në regjistrin publik në Romë dhe si të tilla këto pasuri mund të jenë objekt sekuestrimi. Nga kjo shkresë deduktohet se apartamentet nuk kanë imunitet diplomatik ende deri më 12.03.2014.

Këto apartamente nuk administrohen nga DSHTD, megjithëse kanë kaluar 5 vjet nga korrespondenca e fundit, ende nuk ka informacion mbi regjistrimin e mëtejshëm të tyre. Megjithëse nga DSHTD ka informacione pjesore mbi përdorimin e tyre nga punonjës të ambasadës, ato nuk vijnë si rrjedhojë e një komunikimi zyrtar midis palëve Ambasada e Romës, MEPJ dhe DSHTD. Si vijim nuk mund të konkludohet me qartësi dhe saktësi në lidhje me administrimin e tyre, në kushtet kur ambasada e Romës ka kosto financiare që mund të

mbulojë me buxhetin e saj për akomodimin e personelit të saj, duke i ekspozuar këto pasuri ndaj riskut të mashtrimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, të program auditimit, faqe 72-73 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 12.1. DSHTD në bashkëpunim me MEPJ dhe Ambasadën në Romë, të marrin masa në evidentimin, bërjen transparente të situatës aktuale të regjistrimit të këtyre pasurive të paluajtshme, si dhe vënien në administrimin të këtyre pasurive të paluajtshme nga DSHTD.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se janë 6 procedura me blerje të vogla ku janë vendosur, kriteret kualifikuese të sforcuara, duke ngushtuar shumë konkurrencën e operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 3, datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 7. Pra janë vendosur kriteret të cilat nuk i përmban legjislacioni i prokurimit public, duke zvogëluar konkurrencën në prokurim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të program auditimit, faqe 78-80 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 13.1. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, sektori i prokurimeve, të marrin masa që në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të nxisin konkurrencën duke vendosur kriteret kualifikuese të qarta dhe të aplikueshme nga operatorët, për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit konstatohet se në të dy kontratat e furnizimit me lëndë djegëse solar, afati përfundimtar i lëvrimit është data 31.12.2018/2019, me afat të lëvrimit me kohëzgjatje përkatësisht 6 dhe 8 muajore, ndërkohë që konstatohet një gjendje e mbetur e solarit, e pa lëvruar në fund të kontratës përkatësisht 55,400 litra për vitin 2018 dhe 69,500 litra për vitin 2019. Këto diferenca janë faturuar nga operatori ekonomik me një faturë të vetme në fund të vitit 2018 në faturën nr. 2, datë 28.12.2018 në vlerën 6,674,592 lekë dhe në fund të vitit 2019 në faturën nr. 312, datë 27.12.2019 në vlerën 10,682,845 lekë, të bazuar në një aktmarrëveshje midis DSHTD dhe Kontraktuesit, për sasinë e palëvruar të lëndës djegëse nga operatori dhe të pamarrë ende në dorëzim nga DSHTD. Gjatë likuidimeve nga DSHTD nuk u konstatua sigurim i kontratës nga X përpara lidhjes së saj apo mbajtje e vlerës 5% të garancisë deri në 1 vit pas përfundimit të kontratës, duke e ekspozuar DSHTD ndaj riskut të mospërbushjes së detyrimit të operatorit për shërbimin e prokuruar. Kontrata e lidhur midis DSHTD dhe X për vitin 2018 është bërë për sasinë 113,000 litra solar, dhe vlera e realizuar është në shumën 14,006,037 lekë, ndërsa për vitin 2018 për sasinë 135,000 litra në vlerën 20,297,562 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, të Program Auditimit faqe 67-70 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 14.1. DSHTD të marrë masa në mirëplanifikimin e nevojave për lëndën djegëse për ngrohje, duke parashikuar shtrirjen e kontratës deri në një vit kalendarik nga momenti i lidhjes së saj dhe me një grafik lëvrimi konform kësaj periudhe kohore, pas një monitorimi rigoroz të kërkesës për të.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurën “Blerje/Furnizim karburant Gazoil <10PPM dhe Solar”, për LOTIN II, u paraqitën 2 operatorë ekonomik: OE “X” sh.a me marzhi i fitimit 9 % dhe OE “X-Er” sh.a me marzhi i fitimit 5%. Me shkresën nr. 84/4 prot. Datë 18.03.2019 të rhiqet nga gara operatori “X” sh.a. Me shkresën nr. 84/4 prot. Datë 18.03.2019 të rhiqet nga gara operatori “X” sh.a. Me urdhërin nr. 292/1 prot. Datë 19.03.2019 anulohet procedura e LOTIT II “Blerje/Furnizim Solar”. Procedura “Blerje/Furnizim Solar” rihapet dhe konstatohet se pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi janë të njëjtët operatorë ekonomik: “X” sh.a me marzhi të fitimit 38 %, dhe OE “X-Er” sh.a me marzhi i fitimit 43%. Nga auditimi u konstatua se për procedurën “Blerje/Furnizim Solar”, ofertojnë 2 OE të cilët tërhiqen nga nënshkrimi i kontratës duke i ripërsëritur procedura dhe të njëjtët OE marrin pjesë në rihapjen e procedurës, me marzhe fitimi shumë më të mëdha,

veprime që kanë sjellë përdorime pa efektivitet të fondeve publike, nga AK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të program auditimit, faqe 70-72 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 15.1 DSHTD dhe Sektori i Prokurimit në vijimësi, në raste të ngjashme të analizojnë veprimet e operatorëve ekonomikë, të cilët kanë sjellë rritje të kostos për solarin, me qëllim përdorimin e fondeve publike me efektivitet, ekonomikitet dhe eficensë.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2019, në procedurat e blerjeve të vogla, dhe konkretisht për procedurën e prokurimit “*Shërbim mirëmbajtje vjetore ashensori*” të realizuar në datë 18.01.2019 në vlerë prej 710,000 lekë pa TVSH dhe gjithashtu në datë 18.09.2019 është realizuar procedure prokurimi me vlerë të vogël “*Riparim defekte ashensorë+materiale e pajisje*” me vlerë 484,000 lekë pa TVSH, e cila përbën përdorim të fondeve publike pa eficensë. Sipas specifikimeve teknike të përcaktuara, qëllimi i punës është se operatori fitues duhet të eliminojë të gjitha defektet e shfaqura gjatë punës së ashensorëve dhe riparimin e tyre si dhe shërbimin e detyruar mujor dhe periodik. Mirëmbajtja e ashensorëve do të përmbajë shërbimin e detyruar mujor si dhe riparime e shërbime periodike. Referuar nenit 10 të kontratës “Detyrimet e kontraktorit” pika 2 citon se: *kontraktuesi duhet ti kryejë shërbimet e mirëmbajtjes sipas specifikimeve teknike. Ndërkohë, në datë 18.09.2019, është realizuar procedurë prokurimi me vlerë të vogël “Blerje materiale për ashensorë” me vlerë 484,000 lekë pa TVSH, ku përfshihen: Bateri për ashensorë, grup “SMS Red”, automat, Skedë elektronike micresp, grup operator skede+motor, skede mocab-cam, skede elektronike mimca, motor operator, display tip SIL911, i fituar si blerje e vogël nga OE “X” shpk, i cili ka edhe kontratën nr. 71/2 prot. Datë 23.01.2019, me qëllim “Mirëmbajtje ashensorësh”. Konstatohet se blerja e materialeve për ashensorë, ishte e panevojshme të realizohej pasi grupi i mallrave për “Riparim defekte ashensorë + materiale e pajisje”, përfshihej në kontratën nr. 71/2 prot. Datë 23.01.2019, me objekt “Mirëmbajtje ashensorësh”. Veprimi i mësipërm përbën përdorim të fondeve në vlerën 484,000 lekë pa TVSH, pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficensë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, të program auditimit, faqe 80-83 të Raportit të Auditimit).*

Rekomandimi 16.1. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të marrë masa që në hartimin e regjistrit të parashikimeve të bëjë planifikimin e nevojave duke klasifikuar mallrat apo grup mallrat sipas funksionit, me qëllim mos shmangien e procedurave të prokurimit dhe përdorimin e fondeve me efektivitet në përputhje me VKM nr.914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 1 dhe 8.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i riparimeve në ambasadat e Brukselit dhe Romës u konstatua se, realizimi i blerjeve me vlerë të vogël, në procesverbalin e blerjeve të vogla nuk pasqyrohet në ofertat e marra por vetëm në ofertën e një operatori ekonomik, i cili është likuiduar. Në preventivin e ofertës me palët e treta, me njësinë nuk është përcaktuar specifikisht puna që do të kryhet dhe nëse materialet ndërtimore do të blihen nga palët e treta apo nga DSHTD-ja, pasi shumë materiale blihen nga DSHTD-ja, me procedurë blerje e vogël. Nga punimet me palët e treta, nuk ekziston asnjë kontratë apo marrëveshje, midis operatorëve ekonomikë dhe DSHTD, ku të përcaktohen afate, specifikime, sanksione për defekte etj, por vetëm fatura likuidimi të punimeve. Në hartimin e preventivit paraprak për punime investim-mirëmbajtjes në ambasadat e RSH, nuk janë zbatuar plotësisht kërkesat ligjore, të parashikuara në manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre, apo klasifikimi dhe struktura e kostos së punimeve të ndërtimit, pasi mungojnë analizat teknike e strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit, mangësi kjo e konstatuar vazhdimisht nga

auditimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, por e pa korrigjuar plotësisht, edhe pse vërehet një situatë e përmirësuar nga ana e përgatitjes së dosjes dhe dokumentacionit plotësues të investimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të program auditimit, faqe 88-90 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 17.1. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik të marrë masa që për investimet e ambasadave, të dokumentojë ofertat e marra nga Operatorët Ekonomikë, duke justifikuar shpenzimet. Në oferta me palët e treta, të përcaktohet specifikisht puna që do të kryhet dhe nëse materialet ndërtimore do të blihen nga palët e treta apo nga DSHTD-ja.

Në vijimësi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se fondi prej 760,000 lekë nga të ardhurat e ndërmarrjes për vitin 2018, vënë në dispozicion për “Udhëtimin turistik” të kryer sipas kërkesës për blerje nr.987, datë 04.10.2018 nga Sektori i Administratës si dhe sipas Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar dhe VKM nr.840, datë 17.12.2004 “Për veprimtarinë e DSHTD –së”, është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet. Kryerja e këtij shpenzimi nuk justifikohet me bazën ligjore mbi të cilën është formuluar kërkesa. Sipas nenit 11 të Ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar, pika 1, ky udhëtim është kryer në muajin tetor të viti 2018, pra pa u mbyllur rezultati financiar i këtij viti dhe pa marrë miratim nga MEPJ në kundërshtim me Ligjin 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika1/b. (Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1.1 të Program Auditimit faqe 21-22 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 1.1. Këshilli Drejtues i DSHTD të marrë masa dhe të analizojë shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve prej 760,000 lekë për shpenzimin e “Udhëtimit turistik” jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Kontrata **KQSV-10.2018- X -010**, e nënshkruar me DSHTD- me objekt dhënien me qira të ambjentit në katin përdhe, i cili ndodhet në adresën Rruga “Skënderbej”, Pall. Nr.8, seksioni. Nr.3 me sipërfaqe 108 m² që do të përdoret për tregti të ndryshme ushqimore dhe industriale, është tarifuar me një çmim qeraje prej 6 €/ m², dhe qera mujore 648 euro/muaj pra një çmim më i ulët se ai i miratuar për këtë zonë me VKD dhe konkretisht 1 euro/ m² më pak, veprim që ka sjellë një fitim të munguar prej 108 euro/muaj ose 1296 euro në vit. Rinovimi i kontratës **KQSV-10.2019- X -012** për të njëjtin objekt është kryer në të njëjtat kushte duke sjellë edhe për vitin 2019 një fitim të munguar prej 1296 euro në vit. Pra në total një fitim i munguar prej 2,592 euro për periudhën në auditim. (Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1.2. të program auditimit, faqe 32-33, të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 2.1. DSHTD, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën 2,592 euro.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi u konstatua se në kontratën e lidhur **KQSV-12.2018-XTirana -012**, ndërmjet subjektit privat “XTirana” dhe DSHTD-së për periudhën në auditim, me object ambjentin në katin përdhe 77,7 m² + lulishte funksionale me sip.120,21 m², i cili ndodhet në adresën Rruga “Skënderbej”, Pall. Nr.4 u konstatua se çmimi i tarifimit të qerasë është 4 €/ m² për ambjentin përdhe, dhe 150 lekë / m² për lulishten funksionale e bazuar në nenin 8 të VKM nr.840, datë 17.12.2004, i ndryshuar “Për veprimtarinë e DSHTD-së”. Pra ky subjekt privat është *trajtuar si përfaqësi diplomatike dhe çmimi për m², është në dukje më i ulët se sa ai i miratuar me VKD, për këtë zonë. Trajtimi si rast përjashtimor është në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera”, ku përcaktohet se çmimet favorizuese do të bëhen për shkak të planeve të investimeve në rastet e kontratave mbi 200 m² Konkretisht sipërfaqja prej 77,7m² duhej të tarifohej me 7 €/ m², dhe si rrjedhim do të kishim një vlerë më të madhe në të ardhurat e këtij institucioni.*Konkretisht $77,7 * 3€/ m^2 = 233 \text{ euro/muaj} * 12 = 2796 \text{ euro në vit fitim i munguar për DSHTD-në si dhe për periudhën në auditim } 2796 * 2 = 5592 \text{ euro të ardhura të munguara, pasi në vazhdimësi është lidhur kontrata me këtë subject për vitin 2020, me nr.prot .1096/2, datë 22.10.2019, me të njëjtën bazë ligjore dhe më të njëjtën tarifë qeraje. (Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1.2. të program auditimit, faqe 43-45, të Projekt-Raportit të Auditimit).$

Rekomandimi 3.1. DSHTD, të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën 5,592 euro.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i disa kontratave të qerasë me shoqërinë gjermane X për periudhën në auditim u konstatua se:

a)Në Kontratën KQPH-10.2018 të nënshkruar ndërmjet DSHTD dhe shoqërisë gjermane X, me object dhënien me qira të apart.nr.8.2.7, i cili ndodhet në adresën Rruga Skënderbej, Pall.nr.8, shkalla nr.2, rezultoi se tarifimi i qerasë është kryer me çmim 6,03 €/ m², për një sipërfaqe 265m² dhe afat 11-mujor.Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate është 01.10.2018-31.08.2019.(11 muaj). Ajo që konstatohet është se kemi një ulje prej 0.97 euro.m2 në llogaritjen dhe tarifimin e qerasë pasi çmimi i miratuar sipas VKD për vitin 2018 është 7€/ m², dhe si rrjedhim kemi një fitim të munguar prej 255 euro/muaj dhe rreth 2805 euro të munguara për 11 muaj, për vitin 2019.

b)Në Kontratën KQPH-01.2018-X-004 të nënshkruar ndërmjet DSHTD dhe shoqërisë gjermane X, me object apart.nr. 4.1.4, i cili ndodhet në adresën Rruga Skënderbej, Pall.nr.4, shkalla nr.1, me një afat së kësaj kontrate prej 01.01.2018-31.12.2018.(12-muaj). Ajo që konstatohet është se kemi një ulje prej 0.5 euro.m2 në llogaritjen dhe tarifimin e qerasë pasi çmimi i miratuar sipas VKD për vitin 2018 është 7€/ m², dhe si rrjedhim kemi një fitim të munguar prej 47,66 euro/muaj ose 572 euro të munguara për një vit, për vitin 2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2. të program auditimit, faqe 34-37 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 4.1. DSHTD, të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mungesës së të ardhurave në shumën 3,377 euro.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: a) Nga auditimi u konstatua se kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjektet vendase nga DSHTD, për periudhën në auditim për vonesa në likuidimin e qerave nuk janë vjelë kamatëvonesat përkatëse. Për periudhëm 01.07.2018-30.11.2019, vlera e kamatëvonesave të paarkëtuara është 16,985 euro dhe 180,078 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 1.2. të program auditimit, faqe 45-46, të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 5.1. DSHTD/Spektori i Financës DSHTD, të marrin masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mungesës së të ardhurave prej 16,985 euro dhe 180,078 lekë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2019, në procedurat e blerjeve të vogla, dhe konkretisht për procedurën e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje vjetore ashensori” të realizuar në datë 18.01.2019 në vlerë prej 710,000 lekë pa TVSH dhe gjithashtu në datë 18.09.2019 është realizuar procedure prokurimi me vlerë të vogël “Riparim defekte ashensorë+materiale e pajisje” me vlerë 484,000 lekë pa TVSH, e cila përbën përdorim të fondeve publike pa eficensë. Sipas specifikimeve teknike të përcaktuara, qëllimi i punës është se operatori fitues duhet të eliminojë të gjitha defektet e shfaqura gjatë punës së ashensorëve dhe riparimin e tyre si dhe shërbimin e detyruar mujor dhe periodik. Mirëmbajtja e ashensorëve do të përmbajë shërbimin e detyruar mujor si dhe riparime e shërbime periodike. Referuar nenit 10 të kontratës “Detyrimet e kontraktorit” pika 2 citon se: *kontraktuesi duhet ti kryejë shërbimet e mirëmbajtjes sipas specifikimeve teknike. - Ndërkohë,* në datë 18.09.2019, është realizuar procedurë prokurimi me vlerë të vogël “Blerje materiale për ashensorë” me vlerë 484,000 lekë pa TVSH, ku përfshihen: Bateri për ashensorë, grup “SMS Red”, automat, Skedë elektronike micresp, grup operator skede+motor, skede mocab-cam, skede elektronike mimca, motor operator, display tip SIL911, i fituar si blerje e vogël nga OE “X” shpk, i cili ka edhe kontratën nr. 71/2 prot. Datë 23.01.2019, me qëllim “Mirëmbajtje ashensorësh”. Konstatohet se blerja e materialeve për ashensorë, ishte e panevojshme të realizohej pasi grupi i mallrave për “Riparim defekte ashensorë + materiale e pajisje”, përfshihej në kontratën nr. 71/2 prot. Datë 23.01.2019, me objekt “Mirëmbajtje ashensorësh”. Veprimi i mësipërm përbën përdorim të fondeve në vlerën 484,000 lekë pa TVSH, pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficensë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, të program auditimit, faqe 80-83 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi 7.1. DSHTD të marrë masa që në hartimin e regjistrit të parashikimeve të bëjë planifikimin e nevojave duke klasifikuar mallrat apo grup mallrat sipas funksionit me qëllim mos shmangien e procedurave të prokurimit si dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve prej 480,000 lekë pa TVSH, pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficensë.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE E ADMINSTRATIVE

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik, të vlerësojë në varësi të analizës së përgjegjëse, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë masat që do të marrë DSHTD për zbatimin e rekomandimeve të këtij auditimi, reflektimin e tyre dhe përmirësimin e punës dhe proceseve në fushën e veprimtarisë së DSHTD-së.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

GRUPI I AUDITIMIT

E. LL.

A. K.

I. I.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R